# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-442738**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | "Kemi institucione që nuk garantojnë siguri maksimale kibernetike"/ Kreu i AKSK në Komisionin "Xhafaj", Kazia: Qytetarët të rrezikuar nga mesazhet false |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/14/kemi-institucione-qe-nuk-garantojne-siguri-maksimale-kibernetike-kreu-i-aksk-ne-komisionin-xhafaj-kazia-qytetaret-te-rrezikuar-nga-mesazhet-false/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 10:31:09 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 14 shtator 2026, 10:26:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 14 shtator 2026, 10:25:00 UTC → 14 shtator 2026, 10:27:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `a7dea566f4bb31a836af2ffde6a4dbc562c50c9cffac46ab1e4dbd1675341a59` |
| TEKSTI | `fee0b33b59b636df04ce110733b972f7a5f0596d016cb25f84e4420c252085a7` |
| PAMJA | `d358c6cf0a81fd3ca9d42d3f61232606b96514d74332133c5399a77bbb297e0c` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `2a086384a365eb4b967b18293e9dd662d058c6aa167fc01aefc48d0732f33a65` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `fa5011856be057622e11e3b7b9503371417a521d23e6e858a13f19aee6db6a1d` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/2a086384a365eb4b967b18293e9dd662d058c6aa167fc01aefc48d0732f33a65`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET TË FUNDIT

# "Kemi institucione që nuk garantojnë siguri maksimale kibernetike"/ Kreu i AKSK në Komisionin "Xhafaj", Kazia: Qytetarët të rrezikuar nga mesazhet false

14/09/2026 12:26



**Po mbahet sot Komisioni Komisioni për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale, i drejtuar nga deputeti Fatmir Xhafaj.**

Kreu i Autoritetit Kombëtar të Sigurinë Kibernetike, Bledar Kazia, po relaton në lidhje me institucionin që drejton. Gjatë seancës dëgjimore ai u pyet nga deputetja Evis Kushi nëse institucionet tona janë të afta të përballojnë sulmet kibernetike.

**Kushi:** *Kemi ne institucione të një rëndësie të veçantë që nuk kanë kapacitet e duhura për të pasur sigurinë maksimale kibernetike?*

**Kazia:** *Sa i përket infrastrukturave jetike, këto institucione kanë kapacitete teknologjike dhe njerëzore, por jo të gjitha kanë burimet e duhura për t'iu përgjigjur sulmeve të ndryshme. Vetëm në 5 muajt e kaluara janë vendosur 16 masa administrative për mospërmbushje të detyrimeve për masat që duhet të marrin këto institucione. Duhen investime në teknologji, ndonjëherë është procedurë e gjatë, sepse këto institucione janë pjesë e administratës. Bashkia e Tiranës ka marrë masa, por procedurat kanë ngecur rrugës. Përgjigja është "po", kemi institucione që nuk kanë burimet e duhura për t'i bërë ballë sulmeve kibernetike. Me masat që do të marrim dhe punën që po bëhet, besoj se do të rritet siguria.*

Më pas kryetari Xhafaj e pyeti në lidhje me sigurinë e qytetarëve dhe kërcënimet me të cilat ato përballen sa i përket sigurisë kibernetike dhe të dhënave të tyre online.

**Xhafaj:** *Cilat janë problematikat që një qytetar i thjeshtë has në fushën të përgjegjësisë? Sa jemi në gjendje ne të ruajmë të dhënat dhe privatësinë e qytetarëve tanë, veçanërisht fëmijëve?*

**Kazia:** *Problematika më e madhe janë tentativat "fishing" dhe "smishing", kur përmes mesazheve apo telefonatave u kërkohet të vendosin të dhënat e tyre. Kemi pasur më së shumti mesazhe duke imituar bankat, e-albanian, apo Postën Shqiptare. Kemi pasur bashkëpunim me policinë dhe në 3 raste është bërë i mundur edhe arrestimi i autorëve. Kemi ngritur detektorë që i sinjalizojnë këto mesazhe dhe telefonata dhe në shumë raste i kemi parandaluar. Kemi investuar në rritjen e kapaciteteve dhe çdo vit siguria rritet. Çdo gjë vjen nga ndërgjegjësimi dhe çdo qytetar duhet të tregojë kujdes se më kë komunikon dhe ku i hedh të dhënat e tij. Kemi një platformë online për denoncimet, por do të kemi edhe një platformë për "higjienën kibernetike".*

**Top Channel**


## Aktualitet »

## Kryesore



**Analizë nga Filip Çakuli: Drejtësia kërkon drejtësi… për rrogën e vet!**
11:35

**Alket Rizai duhej të kthehej sot në burg, si ndodhi sherri në plazhin grek, shqiptari zhduket nga vendngjarja pas të shtënave**
08:35

**Trump paralajmëron fundin e luftës në Iran: Mund të ndodhë rreth zgjedhjeve amerikane**
07:48

**Rusia godet një tren në Ukrainë, pak pasi Boris Johnson dhe zyrtarë të lartë europianë kaluan në të njëjtën linjë**
07:12

**Lufta për Topin e Artë, Lamine Yamal: Unë dhe Mbappe jemi dy më të mirët, por këtë vit mendoj se e meritoj çmimin**
07:58

## Më të lexuarat

"Dil jashtë"/ Debati me Ramën gjatë dëgjesës për 'Territorialen' në Berat, Egla Ceno tregon përballjen me kryeministrin: Doja të flisja, ai u çua i irrituar dhe…

Exclusive/ "Rastësia që më lidhi me Artur Zhejin", rrëfehet për herë të parë bashkëshortja e publicistit: Kam dashur vetëm ta ndjek dhe ta adhuroj

Takimi i Ramës në Berat për Territorialen/ Debate në sallë mes kryeministrit, kryebashkiakut të Poliçanit dhe Egla Cenos

E ndoqi në hotel dhe u larguan së bashku nga klubi i natës, 17-vjeçarja gjermane shokon: Më duket se më përdhunoi një burrë 10 vite më i madh

Alket Rizai duhej të kthehej sot në burg, si ndodhi sherri në plazhin grek, shqiptari zhduket nga vendngjarja pas të shtënave

Kishte dalë me leje nga burgu, "tmerri" i policisë greke Alket Rizai hap zjarr në lokal pas sherrit për muzikën, disa të plagosur

"Pengu për dy fëmijët që nuk erdhën kurrë", Soni Malaj rrëqeth me rrëfimin e saj në Grida Duma Podcast

"Nuk po na lejohet të marrim nga qesja jonë"/ Rama i përgjigjet gjyqtarit: E pabesueshme që e shikon kështu buxhetin e shtetit shqiptar

transferimi apo ulja në detyrë të mos ndërpresë procesin e verifikimit

"Një nga mendjet më të ndritura që kishim"/ Nga Grida Duma te Spartak Ngjela dhe Rajmonda Bulku, miqtë kujtojnë Artur Zhejin në 'Exclusive'



E rëndë në Roskovec/ Theu urdhrin e mbrojtjes dhe shkoi në banesën e ish-partneres, 59-vjeçari plagos me drapër ish-vjehrrin

14/09 12:10



Aksident tragjik në Peqin/ Makina përplas të moshuarin me biçikletë, ndërron jetë 70-vjeçari

14/09 11:58



Bllokuan akset kryesore të Tiranës gjatë tubimit të djeshëm, procedohen penalisht 20 protestues

14/09 11:32




Ngecën në Qafë Mollë, dy turistë gjermanë humbin rrugën në terrenin malor pas Dajtit, ndërhyn Policia

14/09 11:28



Nis viti i ri shkollor, hapen dyert e shkollave në të gjithë Shqipërinë, 25 mijë fëmijë nisin sot udhëtimin arsimor

14/09 11:21



Dosja "Partizani"/ Shtyhet seanca për Berishën në GJKKO, avokatët bojkotojnë procesin

14/09 11:06

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »



Top Channel/ PDK-ja kundër Kuvendit të ri, nesër ankimohet edhe formimi i qeverisë



Top News – Dhe zilja ra.../ Nis viti i ri shkollor, hapen dyert për nxënësit



Top Channel/ Nis mësimi mes emocioneve dhe rikonstruksionit në Durrës, rreth 26 mijë nxënës në banka



Top Channel/Vandalizohet statuja e Charlie Kirk në SHBA, mister autori:Po shihen kamerat e sigurisë!



Top Channel/ Jo mësimit pasdite në Fier, prindërit janë kundër, shkollat pa ambiente të mjaftueshme



Top Channel/ Mësim me turne në Gjirokastër, pengohet edhe zbatimi i programit "After School"


**Lajme**
- Lajmet e fundit
- Politikë
- Kronikë
- Aktualitet
- Ekonomi
- Sociale
- Video
- Top News LIVE

**Bota**
- Opinion
- Koment
- Kosova dhe Rajoni
- Shkencë dhe Teknologji
- Auto

**Sport**
- Kombëtarja
- Kategoria Superiore
- Kategoria e Parë
- Premier League
- La Liga
- Serie A
- Shumësportësh
- Sport Gossip

**Pop News**
- Showbiz
- Lifestyle
- Fashion
- Shëndeti
- Dieta
- Receta gatimi

**Programe**
- Big Brother VIP
- Për'puthen
- Shqipëria LIVE
- Fiks Fare
- Video
- Të gjitha programet
- Guida TV

**Top Channel**
- Rreth Top Channel
- Bileta
- Kontakt
- Puno në Top Channel
- Privacy Policy & Terms of Use
- Aksesueshmëria



© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.


Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.